




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.39/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 11 të Rregullores Nr. 15/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për shqyrtim të ankesave të kandidatëve për kryesues/anëtarë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në përbërjen si në vijim:
 1. Nebojša Boričić, gjyqtar në Gjykatën Supreme / kryetar i Komisionit;
 2. Hasim Sogojeva, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme / anëtar i Komisionit;
 3. Teuta Ibrahim, anëtare e KGJK-së / anëtare e Komisionit;
 4. Asllan Krasniqi, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme / anëtar rezervë i Komisionit;
 5. Arjeta Sadiku, anëtare e KGJK-së / anëtare rezervë e Komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 22 shkurt 2024, ka shpallur konkurs të brendshëm për kryesues dhe anëtarë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Me qëllim të mbarëvajtjes së këtij procesi në rast të ankesave eventuale të kandidatëve ndaj vendimeve të Komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve, në këtë takim ka themeluar edhe komisionin për shqyrtim të ankesave, konform nenit 11 të Rregullores Nr. 15/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.